

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN

PËR PËRCAKTIMIN E DETYRAVE DHE BASHKËPUNIMIN E NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE ME SHËRBIMIN VETERINAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi “Për përcaktimin e detyrave dhe bashkëpunimin e njësive të qeverisjes vendore me shërbimin veterinar”, është propozim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në përputhje me Ligjin nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Ky projektvendim synon të bëjë të mundur zbatimin e reformës së shërbimit veterinar, plotësimin e kuadrit ligjor për unifikimin e tij përmes kalimit të kompetencave dhe funksioneve të shërbimit veterinar të pushtetit lokal tek autoriteti kompetent, shërbimi veterinar rajonal si dhe shërbimi veterinar në MBZHR, pasi me miratimin e Ligjit nr. 139/2015 “Për qeverisjen vendore”, pasi njësitë e qeverisjes vendore nuk i kanë më këto funksione. Për këtë qëllim Ligji nr. 71/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, ka si objektiv të përcaktojë detyrat dhe bashkëpunimin e njësive të qeverisjes vendore me shërbimin veterinar si dhe të forcojë masat parandaluese të kontrollit dhe shërbimit, për të garantuar mbrojtjen e shëndetit publik nga sëmundjet zoonotike të transmetueshme nga kafshët.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektakti është parashikuar në programin analitik të akteve për vitin 2021 miratuar me VKM-në nr. 1121, datë 30.12.2020 dhe vjen si nevojë e plotësimit të kuadrit nënligjor në zbatim të Ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Incidentet e ndodhura në të kaluarën në fushën e shëndetit dhe të mirëqenies së kafshëve, të cilat kanë lënë pasojë domethënëse në shëndetin publik, për shkak të transmetimit të sëmundjeve zoonotike apo edhe të lëndëve mbetëse të dëmshme, të cilat gjenden në produktet ushqimore me origjinë shtazore, kanë treguar se një organizim i mirë i shërbimit veterinar, me një linjë vertikale të zinxhirit të komandës dhe llogaridhënies, mund të shmangë në nivel të lartë këto incidente. Në vendin tonë ky zinxhir komande ishte i shkëputur për shkak të fragmentizimit midis pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore.

Mbështetur në pikën 2, të nenit 128, të Ligjit nr. 10465, datë 29.9.20011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili ndryshoi me Ligjin nr. 71/2020, ka parashikuar miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 683, datë 2.9.2020 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve”.

Ngritja e këtij institucioni u imponua nga nevoja për unifikimin e zinxhirit të komandës në shërbimin veterinar dhe shërbimin e mbrojtjes së bimëve në përputhje me misionin që i është dhënë këtij institucioni, si dhe nisur nga ndryshimet e fundit të ligjit të shërbimit veterinar.

Misioni i AKVMB-së është të garantojë mbrojtjen e shëndetit dhe të mirëqenies së kafshëve, mbrojtjen e shëndetit publik në Republikën e Shqipërisë nga sëmundjet zoonotike të transmetueshme nga kafshët dhe mbrojtjen e bimëve.

Nëpërmjet ndryshimeve që sjell ky projektvendim do të mundësohet që shërbimi veterinar aktualisht i fragmentuar në atë të shërbimit veterinar në autoritetin kompetent, strukturat e MBZHR-së dhe atë të njësisë së qeverisjes vendore të unifikohet në zinxhirin e komandës në linjë vertikale duke bërë të mundur kryerjen e funksioneve të shërbimit veterinar të pushtetit vendor nga shërbimi veterinar shtetëror rajonal. Me këto ndryshime ligjore gjithashtu realizohet edhe rekomandimi i vazhdueshëm i dhënë në Raport Progresin e Komisionit Evropian dhe të misionit të OIE-së në vitin 2014 në Shqipëri, për rivlerësimin e kapaciteteve dhe të strukturave të shërbimit veterinar, ku është rekomanduar se “është i një rëndësie kritike rishikimi i roleve dhe përgjegjësive të Ministrisë së Brendshme, veterinerëve të bashkive, duke konsideruar shumë të rëndësishëm transferimin e tyre në shërbimin veterinar shtetëror, pasi sigurohet kapaciteti teknik dhe menaxhues i shërbimit veterinar shtetëror”.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektvendim është hartuar në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk ka përafrim me legjislacionin e BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në këtë projektvendim ka krerë të cilët janë konceptuar në përmbajtje si më poshtë:

- *Kreu I*: “Detyrat dhe bashkëpunimin e njësive të qeverisjes vendore me shërbimin veterinar”:

1. Njësitë e qeverisjes vendore bashkëpunojnë, me drejtoritë rajonale të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB), me drejtoritë rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit si dhe Strukturën Përgjegjëse për Veterinarinë (SPV), për zbatimin e masave profilaktike, për kufizimin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive në kafshë, si dhe për shkëmbimin e menjëhershëm të informacionit.
2. Në rast të konstatimit të një sëmundjeje infektive në territorin që mbulojnë, njësitë e qeverisjes vendore raportojnë menjëherë rastin pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve, pranë Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit në qark, si dhe Strukturën Përgjegjëse për Veterinarinë (SPV), sipas formularit të raportimit të miratuar me urdhër të ministrit.
3. Struktura Përgjegjëse për Veterinarinë në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, informon periodikisht, njësitë e qeverisjes vendore për situatën epizootike në territorin e Republikës së Shqipërisë.

- *Kreu II*: “Përcaktimi i vendndodhjes dhe funksionimin e tregjeve të kafshëve të gjalla, thertoreve dhe kullotave”:

1. Njësitë e qeverisjes vendore përcaktojnë dhe bëjnë publike zonat e përshtatshme për ngritjen dhe funksionimin e tregjeve të kafshëve të gjalla dhe thertoreve, në territorin që ata mbulojnë. Gjatë këtij përcaktimi duhet të ruhet distanca e përshtatshme e vendndodhjes së tregjeve dhe thertoreve nga qendrat e banuara, si dhe lidhja e përshtatshme e tyre me rrugët nacionale, me qëllim mënjanimin e pengesave në qarkullimin rrugor.
 2. Njësitë e qeverisjes vendore bashkëpunojnë me Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB) si dhe me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (AKU) që tregjet dhe thertoret të ngrihen në zona që përmbushin detyrimin e legjislacionit në fuqi në fushën e veterinarisë dhe ushqimit, si dhe të legjislacionit në fushën e licencimit të aktiviteteve.
 3. Njësitë e qeverisjes vendore bëjnë përcaktimin e kullotave dhe të vendeve të pirjes së ujit nga kafshët në varësi të situatës epidemiologjike dhe kur është e nevojshme marrin masa për ndalimin e përdorimit të tyre.
 4. Njësitë e qeverisjes vendore bëjnë publike kullotat dhe vendet e pirjes së ujit nga kafshët, si dhe të çdo mase në lidhje me to.
- *Kreu III: "Mbikëqyrja dhe mbajtja nënkontroll e qenve dhe maceve, endacakë pa pronar":*

1. Njësitë e qeverisjes vendore bashkëpunojnë me drejtoritë rajonale të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve në zbatimin e programeve të profilaksisë veterinarë në lidhje me situatën epizootike të qenve dhe maceve të rrugës, si dhe mbajnë nënkontroll lëvizjen.
2. Njësitë e qeverisjes vendore identifikojnë të gjithë qentë dhe macet e rrugës në territorin që ato administrojnë në një regjistër sipas modelit të hartuar nga Struktura Përgjegjëse për Veterinarinë (SPV). Njësitë e qeverisjes vendore vënë në dispozicion të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të dhënat e regjistrit, sa herë që i kërkohet.
3. Njësitë e qeverisjes vendore kryejnë sterilizimin e qenve dhe maceve të rrugës me qëllim ndërprerjen e aktiviteteve riprodhuese dhe organizojnë grumbullimin e tyre në vende të posaçme të miratuara nga autoritetet e qeverisjes vendore.
4. Njësitë e qeverisjes vendore organizojnë transportin e maceve dhe të qenve të rrugës, me mjete që respektojnë standardet e mirëqenies së tyre drejt vendeve të miratuara nga autoritetet e njësisë së qeverisjes vendore. Në çdo rast, këto mjete duhet të dezinfektohen me dezinfektantë të miratuar nga SPV në ministri. Njësitë e qeverisjes vendore kryejnë eliminimin e qenve dhe maceve të rrugës vetëm në rastet kur:

- a. shfaqin shenja klinike të sëmundjeve infektive;
 - b. gjatë kontrollit për sëmundje zoonotike, kafsha paraqet rrezik për jetën e njeriut;
 - c. kafsha është treguar tepër agresive dhe e egër, si dhe ka sulmuar njerëzit.
5. Eliminimi i kafshëve për rastet e përmendura në pikën 4 të këtij kreu, kryhet me metodën e eutanazisë nga mjeku veterinar që ushtron praktikën mjekësore veterinare, duke përdorur një nga produktet mjekësore veterinare të miratuara.
6. Në të gjitha rastet kur ka braktisje të qenve dhe maceve nga pronarët përkatës, njësitë e qeverisjes vendore marrin masa për zbatimin e pikës 5 të nenit 12, të Ligjit nr. 10 465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe informojnë drejtoritë rajonale të AKVMB-së që mbulon territorin e njësisë vendore.
7. Njësitë e qeverisjes vendore marrin masa, lidhur me vendosjen e sinjalistikës të nevojshme që në ambientet publike, si: rrugë, parqe, kënde lojërash etj., kafshët e shoqërimit të mos paraqesin rrezik për njerëzit ose kafshët e tjera.
8. Njësitë e qeverisjes vendore marrin masa për të vendosur dhe për të zbatuar në territorin në administrim të tyre, detyrimin për pronarët që të vendosin maskën mbrojtëse në gojë për qentë e shoqërimit të racave agresive gjatë qëndrimit të tyre në ambiente publike.
- *Kreu IV* “Organizimi i mbledhjes së kadavrave të kafshëve dhe përcaktimi i vendeve të grumbullimit e asgjësimit të tyre”:
1. Njësitë e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me autoritetet mjedisore rajonale, përcaktojnë vendet e grumbullimit, eliminimit dhe groposjes apo të ndërtimit të krematoriumeve për kadavrat, si dhe i bëjnë publike ato. Grumbullimi, eliminimi dhe groposja apo krematorizimi i kadavrave bëhet në bashkëpunim me shërbimin veterinar shtetëror nga personel i kualifikuar dhe i trajnuar.
 2. Njësitë e qeverisjes vendore kryejnë verifikime të posaçme në terren për egzistencën e kadavrave të pagroposura.
 3. Grumbullimi dhe transportimi i kadavrave bëhet në mjete transporti të përshtatshme, që sigurojnë moskontaminimin e mjedisit prej tyre.
 4. Mjetet e transportit të kadavrave dezinfektohen pas çdo përdorimi me dezinfektantë të miratuar nga Struktura Përgjegjëse për Veterinarinë (SPV) në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

- *Kreu V*: "Rrethimi dhe ruajtja e pikave të grumbullimit të ujërave të zeza dhe ndalimi i hyrjes së kafshëve në to":

1. Njësitë e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me autoritetet mjedisore rajonale, përcaktojnë vendet e grumbullimit të ujërave të zeza dhe sigurojnë rrethimin fizik të tyre me mjete solide e të pakalueshme, për të garantuar ndalimin e hyrjes së kafshëve dhe njerëzve në to. Njësitë e qeverisjes vendore njoftojnë menjëherë shërbimin veterinar shtetëror në rastet e konstatimit të hyrjes së kafshëve në vendet e grumbullimit të ujërave të zeza.
2. Njësitë e qeverisjes vendore marrin masa për pajisjen me sinjalistikën e nevojshme, të dallueshme dhe të qartë për publikun, të vendëve të grumbullimit të ujërave të zeza.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen njësitë e qeverisjes vendore, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si ministria përgjegjëse për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë ka përgatitur këtë projektvendim.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij vendimi nuk sjell efekte financiare për buxhetin e shtetit.

